



Nje super ndeshje ne Vlore dhe ne fund Flamurtari ka festuar ndaj Skenderbeut. Shume vite pa fituar dhe serish keshtu per kampionet e vendit ne transferten vlonjate. Nje gol i shpejte i Shehaj ne pjesen e pare, nje super loje nga Flamurtari dhe me pas vjen incidenti ne tribune me goditjen e presidentit te Skenderbeut Takaj. Ndeshja u pezullua per 30 minuta dhe me nisjen e saj kampionet kane deshire per ta permbysur rezultatin dhe barazojne menjehere me Muzaken qe nuk feston ne respekt te ish skuadres se tij. Pjesa e dyte eshte me e mire per Skenderbeun qe i shkon shume prane shenimit golit te dyte ne disa raste me Pejic dhe Muzaken por Xhelilaj eshte shpetimtari i vlonjateve. Takimi luftohet shume, tifozet shajne e ofendojne sa munden dhe tensioni eshte i larte. Ne minutat e fundit te ndeshjes Flamurtari shton presionin dhe shperblehet me golin e Begaj qe ngre ne peshe stadiumin per suksesin e rradhes ndaj Skenderbeut qe i jep vlonjateve edhe kreun e tabelës pas javes se dyte.